

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Fejzullah Rexhepi kryetar, Isa Shala dhe Rustem Thaqi anëtarë, në çështjen juridike të paditësit B.K. nga Prishtina, kundër të paditurës KS “NN”, në Prishtinë, të cilën e përfaqëson N.B., juriste e diplomuar me autorizim, në çështjen për kompensim të dëmit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, C.nr.652/2008, të datës 19.07.2010, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën **25.10.2017**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET si pjesërisht e themeltë ankesa e të autorizuarës të paditurës KS “NN”, në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, C.nr.652/2008, të datës 19.07.2010, **NDRYSHOHET** sa i përket pikës II.b) të dispozitivit, për kompensimin e dëmit material dhe **REFUZOHET** kërkesa për shpërblimin e dëmit në emër të rehabilitimit klimatik në shumën prej 200.00€, si dhe **NDRYSHOHET** pjesa që ka të bëjë me kamatën si në pikën II. të dispozitivit, ashtu që gjykon dhe duhet të jetë: me kamatë e cila vlen si për mjetet e deponuara në bankat që operojnë në Kosovë, në afat prej një viti pa destinim të caktuar, duke filluar nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë datë 19.07.2010, e deri në pagesën definitive, **ndërsa aktgjykimi i atakuar në pjesën tjetër VËRTETOHET.**

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.652/2008, të datës 19.07.2010, ka miratuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit B.K. nga Prishtina dhe detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve “NN”, që paditësit në emër të dëmit të pësuar jo material dhe material të shkaktuar në aksidentin e trafikut më datën 26.06.2017, në Prishtinë, të ia kompensoi shumat dhe atë: I. a). Dëmi jomaterial- në emër të dhimbjeve trupore fizike, shumën prej 3.500.00 €, në emër të frikës së përjetuar, shumën prej 2.500.00 €, në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, shumën prej 2.000.00 €. II. b). Dëmi material- në emër të ndihmës dhe kujdesit të personit të tretë shumën prej 400.00 €, në emër të ushqimit të përforcuar, shumën prej 225.00 €, në emër të rehabilitimit klimatik, shumën prej 200.00 €. Në shumë të përgjithshme prej 8.825.00 €, të gjitha këto me kamatë prej 3.5 %, të cilën banka e paguan në mjetet e deponuara për një vit pa destinim të caktuar, duke filluar prej ditës së ushtrimit të padisë më datë 11.04.2008, e deri në pagesën definitive, si dhe të ia kompensoi shpenzimet e procedurës kontestimore, në shumë prej 961.00 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit me dhunë. Në pikën dy, kërkesëpadia e paditësit, e cila ka të bëjë me kërkesë për kompensimin në shumën më të lartë se sa shumat e aprovuar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi dhe atë: në emër të dhimbjeve

trupore fizike prej 3.500 €, deri në shumën e kërkuar prej 4.200 €, në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor prej 2.000 €, deri në shumën e kërkuar prej 3.000 €, si dhe në emër të ndihmës dhe kujdesit të personit të tretë prej shumës prej 400 €, deri në shumën e kërkuar prej 450 €, si dhe kamatën prej 4.5%, refuzohet si e pa bazuar.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë e paditura, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që ankesa të pranohet dhe aktgjykimi të priset.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 të LPK-së dhe gjeti se:

-Ankesa është pjesërisht e themeltë

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi ka ushtruar padi ndaj të paditurës me kërkesë për kompensim dëmit material dhe jo material të pësuar në aksident të komunikacionit. Përgjigje në padi ka paraqitur e paditura, duke e kontestuar në tërësi si të pa bazuar. Me parashtresën e datës 22.06.2010, paditësi ka bërë rregullimin dhe precizimin e kërkesëpadisë. Gjykata Komunale në Prishtinë, me aktgjykimin C.nr.652/2008, të datës 19.07.2010, ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit. Gjykata e shkallës së parë pas mbajtjes së seancës kryesore dhe administrimit të provave vendosi si në dispozitiv të aktgjyimit të atakuar duke u bazuar në nenin 189, 193, 197 dhe 200 të LMD-së, ndërsa sa i përket shpenzimeve të procedurës gjykata është bazuar në nenin 452 al. 2, të LPK-së.

Kundër këtij vendimi ankesë ka paraqitur e paditura, duke propozuar që i njëjti të priset dhe lënda të kthehet në rivendosje.

Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me aktgjykimin Ac.nr.1134/2010, të datës 13.11.2012, ka refuzuar ankesën e të paditurës si të pa themeltë, ndërsa ka vërtetuar aktgjykimin e atakuar.

Më datë 24.12.12, e paditura ka paraqitur revizion, me propozim që i njëjti të pranohet dhe të prishë aktgjykimin C.nr.652/2008, të datës 19.07.2010, dhe aktgjykimin Ac.nr.1134/2010, të datës 13.11.2012, për shkak se çështja është çështje e gjykuar (res iudicata).

Gjykata Supreme e Kosovës, me aktvendimin e saj, Rev.nr.175/2013, të datës 23.10.2013, ka pranuar si të bazuar revizionin e të paditurës dhe ka prishur aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac.nr.1134/2010 të datës 13.11.2012 dhe lënda i është kthyer gjykatës së shkallës së dytë në rigjykim.

Gjykata e Apelit ka marr parasysh udhëzimet e dhëna si në aktvendimin Rev.nr.175/2013 të datës 23.10.2013 të Gjykatës Supreme të Kosovës. Pasi ka shikuar provat e paraqitura me revizion sipas udhëzimeve në aktvendimin sipas revizionit dhe atë: marrëveshjen jashtëgjyqësore lidhur me lëndën gjyqësore C.nr.652/08 të datës 21.07.2011, të lidhur në mes të paditësit dhe të paditurës, si dhe një urdhër debitimi në emër të B.K. të kryer në Bankën Ekonomike Sh.a, të datës 01.08.2011, të cilat janë paraqitur në kopje, Gjykata e Apelit vlerëson se marrëveshja jashtëgjyqësore nuk paraqet bazë juridike që një çështje të trajtohet si çështje e gjykuar, në rastin kur ka filluar procedura gjyqësore dhe Gjykata ka vendosur me aktgjykim lidhur me kërkesëpadinë, nuk është në mundësinë e paditësit që ta tërheqë padinë dhe kërkesëpadinë, dhe kjo është përcaktuar me nenin 149 par.1 dhe 261 par.2, të LPK-së, që

nënkupton se pala paditëse mund të disponojë me kërkesën e saj deri në përfundimin e shqyrtimit, por kjo e drejtë nuk i është dhënë pas kësaj faze, sipas dispozitave të LPK-së. Marrëveshja jashtëgjyqësore në formën si është lidhur nuk paraqet titull përmbartës, dhe Gjykata me rastin e vlerësimit të aktgjykimit të ankimuar dhe pretendimeve ankimore nuk është e lidhur me ujdinë jashtëgjyqësore. Me dispozitat e ligjit të procedurës kontestimore, nenin 415.2, është dhënë mundësia që edhe gjatë procedurës sipas ankesës të arrihet pajtimi gjyqësor dhe në këtë rast gjykata e shkallës së dytë, përfundon procedurën e ankimit me supozim se është tërhequr ankesa, kurse me nenin 415.4 është rregulluar që, *“po që se pajtimi gjyqësor bëhet pas dhënies së aktgjykimit të shkallës së parë, atëherë gjykata me aktvendim e anulon aktgjykimin e tillë. Aktgjykimi anulohet nga gjykata e shkallës së parë edhe kur pajtimi është bërë gjatë zhvillimit të procedurës së shkallës së dytë”*. Në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me propozim për arritjen e ujdisë gjyqësore, që do ta obligonte gjykatën të veprimi konform këtyre dispozitave, andaj edhe ankesa është trajtuar sikur kjo parashtresë e dorëzuar për pajtimin jashtë gjyqësore të mos ishte paraqitur (ekzistonte) fare. Është në vullnetin e palëve që t’i përmbahen apo jo pajtimin jashtëgjyqësor, por derisa të ekziston lënda në shqyrtim gjyqësor të njëjtit kanë për obligim që t’iu përmbahen dispozitave ligjore lidhur me procedurat gjyqësore, ndërsa gjykatat janë të lidhura me vendimet e tyre, deri sa nuk ka propozim për ujdi gjyqësore.

Gjykata e Apelit ka ndryshuar aktgjykimin e atakuar, sa i përket pikës II.b) të dispozitivit, për kompensimin e dëmit material dhe ka refuzuar kërkesa për shpërblimin e dëmit në emër të rehabilitimit klimatik në shumën prej 200.00

€, pasi nga shkresat e lëndës është vërtetuar se paditësi për këtë formë të dëmit gjykatës nuk i ka ofruar prova se i është nënshtruar rehabilitimit klimatik. Po ashtu Gjykata e Apelit ka ndryshuar aktgjykimin e atakuar sa i përket kamatës si në pikën II. të dispozitivit, ashtu që ka gjykuar dhe duhet të jetë: me kamatë e cila vlen si për mjetet e deponuara në bankat që operojnë në Kosovë, në afat prej një vit pa destinim të caktuar, duke filluar nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë datë 19.07.2010, e deri në pagesën definitive.

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit, të atakuar në pjesën tjetër si në pikën I. dhe pikën II. të dispozitivit, në pjesën vërtetuese, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe nuk ka shkelje nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, nuk ka aplikim të gabuar të drejtës materiale për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Gjykata e shkallës së parë në tërësi e ka vërtetuar gjendjen faktike e cila nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore dhe kështu e kishte një pasqyrë reale mbi gjendjen në këtë çështje juridike, për këto arsye aktgjykimi i atakuar i shkallës së parë, është vërtetuar në pjesën tjetër si në pikën I. dhe pikën II. të dispozitivit, në pjesën vërtetuese.

Gjykata e Apelit ka vlerësuar se sa i përket bazës juridike të kërkesëpadisë dhe obligimit të paditurës si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, për kompensimin e dëmit palës paditëse, në bazë të provave të administruara nuk është kontestuese, pasi nga shkresat e lëndës respektivisht nga ekspertiza e komunikacionit e datës 06.09.2007, e kryer nga eksperti K.G. lidhur me

shkaktimin e aksidentit të datës 26.06.2007, rreth orës 14:00, në lagjen e Dardanisë, ish-parkingun e flamurtarit në Prishtinë, ku pjesëmarrës ka qenë vetura e tipit Renault me targa 116-KS-733, të cilin e ka drejtuar F.H. dhe këmbësorit- të dëmtuarit B.K., në bazë të cilës ekspertizë, si dhe Raportit të aksidentit 2007-AD-01778, të datës 26.06.2007, të Stacionit Policor në Prishtinë, lidhur me aksidentin nuk ka asnjë dyshim se përgjegjësinë për shkaktimin e aksidentit e ka bartur ngasësi i veturës Renault, e cila ka qenë e siguruar në bazë të policës së sigurimit 0000677337, për sigurimin e auto përgjegjësisë ndaj personave të tretë të lëshuar nga e paditura. Andaj është i pa bazë pretendimi ankimor i të paditurës, se nuk është vërtetuar baza e përgjegjësisë së të paditurës për kompensimin e dëmit, pasi e paditura gjatë shqyrtimit nuk ka parashtruar propozim për nxjerrjen të ekspertizës së re me qëllim të kundërshtimit të përfundimit si në ekspertizën e komunikacionit të datës 06.09.2007, e kryer nga eksperti K.G..

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, ka vendosur drejtë, pasi paditësit i takon e drejta në kompensim të dëmit, duke u bazuar në dispozitat e nenit 323 të LPK-së, nenit 154, 178 dhe 200 të LMD-së¹, andaj shumat e gjykuara si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar për paditësin B.K., për dhimbjet fizike të përjetuara shumë prej 3.500.00 €, për frikën e përjetuar shumë prej 2500.00 euro, në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, shumë prej 2.000.00 €, në emër të ndihmës dhe kujdesit të personit të tretë shumë prej 400.00 €, në emër të ushqimit të përfunduar shumë prej 225.00€, të cilin qëndrim e pranon edhe Gjykata e Apelit dhe konsideron se vendosja si në aktgjykim është gjykim i drejtë i kompensimit në të holla, duke pasur parasysh rrethanat e rastit konkret e posaçërisht kohëzgjatjen dhe intensitetin e këtyre dhimbjeve dhe se ky lloj i kompensimit përfaqëson satisfakcion i cili shërben për vendosjen e baraspeshës me rëndësinë e shkeljes së të mirave të paditësit dhe qëllimit se ky kompensim ka efekt të shpërblimit jo material dhe nuk ka karakter të shpërblimit material. Së fundi nga mendimi i ekspertëve të mjekësisë rrjedh se lëndimet e pësuar janë të natyrës së rëndë trupore dhe si pasojë e në përputhje me natyrën e lëndimeve shuma e gjykuar në emër të kompensimit të dëmit jo material është në përpjesëtim dhe në harmoni me natyrën e synimeve të pajtueshme me natyrën e tyre.

Gjykata e Apelit pretendimet ankimore sipas ankesës të ushtruar nga i autorizuari i të paditurës i konsideron si të pa bazuara, pretendimi ankimor se shumat e gjykuara janë shumë të larta dhe tejkalojnë qëllimin e kompensimit të dëmit, ky pretendim për Gjykatën e Apelit është i pa bazuar, për faktin se gjykata e shkallës së parë sa i përket dëmit jo material ka vendosur sipas kërkesëpadisë së paditësit, si në dispozitiv të aktgjykimit duke u bazuar në ekspertizën e dhënë me datë 18.06.2010, nga ekspertët dr. S.S. ortoped, dhe dr. V.S., psikiatër, të cilët kanë vlerësuar se paditësi B.K. në aksidentin e datës 16.06.2007, ka pësuar lëndime të rënda trupore të cilat kanë shkaktuar dhimbje të intensitetit posaçërisht të rënda 15 minuta, dhimbje të intensitetit të rëndë të në kohëzgjatje 3 ditë, dhimbje të intensitetit të mesëm që kanë zgjatur katër javë dhe dhimbje të intensitetit të ulët ka në vazhdimësi, frika primare të intensitetit të lartë ka ekzistuar për dy tre sekonda, frika sekondare të intensitetit të lartë ka zgjatur një orë, frika sekondare e intensitetit të mesëm një javë dhe frika sekondare e intensitetit të ulët 4 muaj, duke marrë parasysh natyrën e lëndimeve të pësuar, dhimbjet dhe frikën e përjetuar Gjykata e Apelit vlerëson se shumat e gjykuara janë reale dhe në harmoni me praktikën gjyqësore.

¹ LMD-së-ligji për marrëdhëniet e detyrimeve publikuar në GZ të RSFJ-së nr.29, dt.26.05.1978,

Gjykata e Apelit vlerëson se sa i përket dëmit material, për kompensimin në emër të ndihmës dhe kujdesit të personit të tretë shumën prej 400.00 €, në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej 225.00€, i vlerëson sy gjykim i drejtë duke marrë për bazë ekspertizën mjekësore se paditësi ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar për gjashtë javë dhe për nevojën e kujdesit të personit tjetër për gjashtë javë, si dhe nuk ka pasur pretendime ankimore, andaj edhe nuk do të arsyetohet në mënyrë të veçantë.

Gjykata e Apelit ka ndryshuar aktgjykimin e atakuar sa i përket gjykimit për kamatë, pasi aktgjykimi i shkallës së parë në pikën II palës paditëse i ka njohur të drejtën me kamatë prej 3.5 %, të cilën banka e paguan në mjetet e deponuara për një vit pa destinim të caktuar, duke filluar prej ditës së ushtrimit të padisë më datë 11.04.2008, e deri në pagesën definitive, ndërsa duke u bazuar në dispozitat e Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (ligji i vjetër i aplikueshëm në këtë rast), sipas nenit 277, është ndryshuar pjesa që ka të bëjë me kamatën si në pikën II të dispozitivit ashtu që ka gjykuar: me kamatë e cila vlen si për mjetet e deponuara në bankat që operojnë në Kosovë, në afat prej një vit pa destinim të caktuar, duke filluar nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë datë 19.07.2010, e deri në pagesën definitive.

Gjykata e Apelit vlerëson se sa i përket shpenzimeve të procedurës me të cilat e paditura është obliguar që t'ua kompensoj paditësit në shumën prej 961.00 euro, është vendosur në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme, pasi nga shkresat e lëndës rezulton se janë arsyetuar në tërësi nga gjykata e shkallës së parë.

Gjykata e Apelit ka vlerësuar se vendosja si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar sa i përket pjesës refuzuese si në dispozitiv, është vërtetuar dhe ka mbetur e pa shqyrtuar pasi pala paditëse nuk ka ushtruar ankesë, ndërsa pala e paditur nuk ka interes që aktgjykimi të goditet në këtë pjesë.

Nga të cekurat u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi në bazë të nenit 195.1 pika d) dhe e), e lidhur me nenin 200 të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.3987/2013, më datë 25.10.2017

Kryetari i kolegjit-gjyqtari
Fejzullah Rexhepi